



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Zakonodavna Kancelarija - Legal Office

Raporti për Thjeshtësimin dhe Harmonizimin e Lejeve dhe Licencave në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare¹

¹ Kjo analizë juridike është miratuar në Mbledhjen e 254-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/254 të datës 26.03.2025.

Shkurtesat:

GIZ – Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

LPPA – Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative

LKE – Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike

LSHP – Ligji Nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare

LSLL – Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave

PVK – Pikat e Vetme të Kontaktit

RQLL – Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave

ZKM – Zyra e Kryeministrit

ZL – Zyra Ligjore

ARKEP – Komisioni i Pavarur për Media

1.Hyrje

Ky raport i mbështetur nga GIZ ka për qëllim që të pasqyrojë të gjeturat dhe rekomandimet e përgjithshme dhe konkrete, për thjeshtimin e procedurave për aplikim, shqyrtim dhe pajisjen me leje dhe licenca në ARKEP si dhe të bëjë harmonizimin e lejeve dhe licencave të ARKEP me kërkesat dhe kriteret e LSSL. Thjeshtësimi i lejeve dhe licencave është vlerësuar në kuadër të disa parimeve dhe kërkesave të cilat përcaktohen në LSSL si dhe në LPPA, kurse harmonizimi është vlerësuar në kuadër të përshtatshmërisë së ligjeve të veçanta, veçanërisht LKE me LSSL.

Në kuadër të këtij raporti është ndjekur metodologji e atillë, ku janë nxjerrë: **1. Rekomandime të përgjithshme dhe 2. Rekomandime të veçanta**, për lejet dhe licencat të cilat i aplikon ARKEP. Rekomandimet e veçanta janë të vendosura në shtojcën e këtij raporti dhe janë të dhëna për secilën leje ose licencë, në mënyrë të veçantë, sipas të gjeturave.

Po ashtu, përveç rekomandimeve në raport janë përshkruar edhe të gjeturat kryesore si dhe të gjeturat e veçanta, të cilat ndjekin qëllimin e raportit, për thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave si dhe harmonizimin e tyre me LSSL.

Thjeshtëzimi i lejeve dhe licencave dhe harmonizimi i tyre në ARKEP, sipas këtij raporti, merr parasysh veçanërisht:

1. Lehtësimi i procedurës së aplikimit për leje dhe licenca;
2. Lehtësimi i barrës administrative të palës me rastin e aplikimit;
3. Lehtësimi i procedurës së shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të provave/ dëshmive;
4. Çështjen e sigurisë së bartësit të licencës, në kuptim të zgjatjes së afatit, bazuar në kriteret e specifikave të licencave ose lejeve, varësisht nga niveli i rrezikshmërisë;
5. Çështja e ligjshmërisë së licencave, dhe bazës specifike ligjore, në kuptimin që të njëjtat të jenë të parapara me ligj, sipas emërimit nga ARKEP, bazuar në regjistrin qendror të lejeve dhe licencave;
6. Çështjen e harmonizimit dhe përshtatshmërisë së kërkesave të LSSL me rregullimet e përcaktuara në LKE dhe aktet nënligjore.

Për të hartuar këtë raport janë shqyrtuar disa burime dhe atë si në vijim: LSSL; LPPA; LKE; Ligjet e veçanta të aplikuara nga ARKEP; Aktet nënligjore të ARKEP që rregullojnë procedurën e pajisjes me leje dhe licenca që i lëshon ARKEP; RQLL. Po ashtu një rëndësi të veçantë e kanë pasur edhe takimet me institucionet relevante të cilat kanë shërbyer për sqarime shtesë.

Për efekte të këtij raporti është përdorur terminologjia e emërimit “leje dhe licenca” sipas LSSL që përfshijnë edhe aplikimin e llojeve të tjera të lejimeve që lëshohen nga ARKEP dhe nuk emërtohen si leje dhe licenca.

2.Analiza ligjore përkitazi me thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave

Në këtë pjesë prezantohet analiza e legjislacionit kryesor që rregullon lejimet (lejet dhe licencat) në ARKEP. Ligji për sistemin e lejeve dhe licencave (LSLL) është ligji horizontal që në nenin 1 rregullon parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës. Ligj tjetër horizontal që rregullon në përgjithësi ushtrimin e autoritetit publik ku më së shpeshti vije në shprehje tek lejimet është Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), qëllimi i të cilit është të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë në nenin 1 edhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave. Më poshtë do të analizojmë disa nga parimet dhe rregullat kryesore të parashikuara në këto ligje dhe rregullat si dhe kriteret e veçanta që përcaktohen me Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (LKE), me Ligjin Nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare si dhe ligjet tjera, për lejet dhe licencat në ARKEP. Sa më sipër, realizimi i qëllimit të raportit për lehtësimin e lejeve dhe licencave të cilat lëshohen nga ARKEP, kërkon një analizë të ligjeve të veçanta, siç është veçanërisht ligji për LKE dhe aktet nënligjore që i nxjerr ARKEP, në kuptim të lejeve dhe licencave të cilat i lejon, në veprimtaritë e caktuara. Sistemi i lejeve dhe licencave, procedura, mënyra e dhënies së tyre, kriteret etj, rregullohen Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, Ligjin Nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare, Rregulloret si dhe aktet tjera nënligjore të ARKEP-së të aplikueshme për procesin e aplikimit.

Në kuptim të emërimit, LSLL në nenin 1 (1.3) përdor termin ***“I licencuari – personi fizik të cilit i është lëshuar një licencë profesionale”***, në anën tjetër Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (LKE) i referohet nenit 4 (1.46): ***“Person – cilindo person fizik, juridik apo publik, duke përfshirë këtu edhe korporata, partneritete, truste, organizata të painkuadruara, ofrues të shërbimeve, Qeverinë apo çfarëdo institucioni që ka të bëjë me të.”*** Gjithashtu, neni 10, paragrafi 14, po i njëjtit Ligj, përcakton se ***“Lëshon autorizime dhe akte të tjera në pajtueshmëri me dispozitat e këtij ligji, si dhe rregulloret e miratuara, duke u bazuar në këtë ligj”***

Përderisa LSLL në nenin 5 ka përcaktuar llojet e lejeve, siç janë: *njoftimi, regjistrim, leja dhe licenca profesionale*, në anën tjetër ARKEP njeh dhe aplikon me shume autorizimet në vend të *licencës dhe lejeve*. Megjithatë, siç do të shihet më poshtë, tek rekomandimet e përgjithshme dhe të veçanta, disa lejeve (autorizime dhe licenca) të ARKEP-së, megjithatë nuk kanë një bazë konkrete ligjore në ligjin për LKE. Nisur nga koncepti i harmonizimit, në përputhje me LSLL, kjo kërkohet që të bëhet me ligj.

Në kuadër të sistemit të lejeve dhe licencave të cilat lëshohen nga ARKEP, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike dhe në Ligjin Nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare, çështja e lehtësimit të lejeve dhe licencave në këtë sektor siç u tha do të shikohet bazuar në disa parime, të cilat njihen nga LSLL dhe LPPA. Këto parime kanë për qëllim të arrijnë në rekomandime konkrete, për të bërë lehtësimin e lejeve dhe licencave të ARKEP si dhe harmonizimin e tyre me kërkesat dhe kriteret e LSLL.

Afati i kohëzgjatjes së licencës. Ky parim përcaktohet në nenin 6 të LPPA dhe si i tillë duhet të aplikohet edhe nga ARKEP. Varësisht nga lloji i lejeve dhe licencave, Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike ka përcaktuar kohëzgjatjen për 10 vite ose me shume për të drejtat individuale për shfrytëzim të radio-frekuencave. Gjithashtu për vazhdimin e afatit të licencës apo lejes nga ARKEP në varësi nga lloji, bazohet në kriteret e kualifikimit, kriteret e dhënies dhe kriteret e tjera. Afati i kohëzgjatjes së licencës është e rëndësishme të ndërlihdur me parimin e efikasitetit, sipas nenit 10 të LPPA. Gjithashtu kohëzgjatje do të mund të lidhej me nivelin e rrezikut, sigurisë, mbrojtjes së shëndetit publik, llojit të veprimtarisë dhe aspekteve të tjera të rëndësishme që mund të dallojnë varësisht nga leja dhe licenca konkrete.

Parimi i mos diskriminimit. Ky parim përcaktohet në nenin 6 të LPPA dhe si i tillë duhet të aplikohet edhe nga ARKEP, në raport me vendosjen për licencat dhe lejet e tjera që i bën. Veçanërisht ky parim duhet të përcaktohet në mënyrë strikte kur bëhet fjale tek kohëzgjatja e licencës, të cilën ARKEP e vlerëson dhe e vendos, sipas diskreditonit duke u bazuar në kriteret e kohëzgjatjes minimale dhe maksimale të afatit të kohëzgjatjes.

E Drejta e ankesës. Kjo përbën një obligim kushtetues. Sistemi i shqyrtimit të licencave në ARKEP si dhe procedurat për këtë, parashohin të drejtën e ankesës në rast të refuzimit, pra në nenet 66 dhe 72. Çdo vendim apo veprim i ARKEP-së, Ministrisë ose cilitdo Autoritet tjetër publik i cili është marrë në bazë të autorizimit të këtij ligji i nënshtrohet edhe shqyrtimit administrativ dhe atij gjyqësor si dhe ankesës, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parapara në Ligjin për Procedurën Administrative. Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, dorëzimi i Ankesës përkatësisht nenit 66 (2): “...ankesat që i pranon dhe kanë të bëjnë me shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara apo që pretendohet të ofrohen nga ai dhe të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit”. E drejta për refuzimin e licencës ose lejit përcaktohet edhe me LSSL, respektivisht nenin 27.

Pagesa e taksave. LSSL përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejin. Në anën tjetër, LPPA përcakton mos pagesën e procedurës dhe sipas kësaj kjo pagesë mund të bëhet vetëm në raste kur përcaktohet ndryshëm me ligj. Në rastin e ARKEP-se sipas Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, në neni 27 dhe në nenin 47 (12): “Pagesat për të shfrytëzuar të drejtën e përdorimit të resurseve të komunikimeve elektronike duhet të paguhet në buxhetin e shtetit nga tenderuesi i suksesshëm apo fituesi i ankandit. Në rastet kur tenderuesi i suksesshëm apo fituesi i ankandit e vonon pagesën, apo pjesë të pagesës, Autoriteti e ka të drejtën të marrë vendim për imponim të obligimit në tenderuesin e suksesshëm apo fituesin e ankandit që të bëjë pagesat në kohë të caktuar dhe të vendosë kufizime kohore për pagesat në fjalë. Vendimi i marrë nga Autoriteti duhet të jetë dokument ekzekutiv. Nëse vendimi nuk është zbatuar duhet të përcillet për ekzekutim në pajtim me procedurat e vendosura në legjislacionin në fuqi për procedurë penale. Vendimi duhet të ekzekutohet brenda afatit tre (3) vjeçar nga data e prurjes së këtij vendimi” apo edhe në nenin 57 (1): “Pagesat e rregullta vjetore duhet të paguhet për përdorimin e spektrit të radio-frekuencës, gjithashtu kalkulimi, si dhe shuma e pagesave, po ashtu edhe mënyra e pagesës duhet të miratohet nga Autoriteti në përputhje me dispozitat e nën-paragrafit 2.6. të paragrafit 2. të nenit 54 të këtij ligji”. Ndërsa me detaje janë listuar në nenin 83 po të njëjtit ligj: 1. “Në Buxhetin e Kosovës bëhen pagesat lidhur me veprimtarinë e Autoritetit, si në vijim: 1.1. pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve në nenin 27 të këtij ligji; 1.2. pagesa për financimin e shërbimit universal; 1.3. pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas përcaktimeve në nenin 57 të këtij ligji; 1.4. pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike; 1.5. pagesat nga dënimet ekonomike të shqiptuara nga Autoriteti; 2. çdo taksë apo pagesë tjetër e paraparë me këtë ligj depozitohet në Buxhetin e Kosovës”. . Taksat e shqyrtimit të licencës paguhet në momentin e shqyrtimit të aplikacionit.

Parimi i një sporteli të vetëm (pikat e vetme të kontaktit), është obligim ligjor i përcaktuar si në LSSL, respektivisht nenin 16 ashtu edhe në LPPA si dhe LPPA nenin 33. Sipas këtij parimi të gjitha formalitetet dhe procedurat për lëshimin e një leje dhe licence duhet të kryhen përmes PKV të kontaktit (one stop shop). Të dyja ligjet lejnë hapësirë që PKV të krijohen në mënyrë fizike, elektronike apo të kombinuara. Parakusht kryesor për t'i krijuar PKV janë pikat që i cekëm më lartë, sidomos qasja e orientuar nga parimi i shqyrtimit administrativ sipas detyrës zyrtare.

Parimi i aplikimit të ndihmës administrative. Neni 34 i LPPA përcakton se organi publik mund të kërkojë ndihmë nga një organ tjetër publik, ndër të tjera për njohjen me fakte, dokumente apo mjete të tjera të

provës në posedim të organit tjetër. Ky parim mund të përdoret për të lehtësuar procedurën e verifikimit të dokumenteve të nevojshme. ARKEP në rastin e shqyrtimit të procedurës së lejeve dhe licencave nuk e aplikon fare parimin e ndihmës juridike.

Shqyrtimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Këtë parim e lejon neni 86 i LPPA. Në fakt ky parim në dritën e lehtësimit të procedurave për dhënin e licencave në ARKEP, bazuar mënyrën se si rregullohet procedura e licencimit në ARKEP duhet të kombinohet me parimin e aplikimit të ndihmës administrative. ARKEP nuk aplikon fare parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Neni 86.3 i LPPA, në lidhje me këtë parim përcakton: ***“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t’i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre”***. Kjo nënkupton që në disa raste, kur dokumentet dhe kushtet e dokumentacionit për një licencë, nuk përcaktohen me ligj, atëherë ARKEP në rastin konkret mund të kërkojë nga pala që vetëm të evidentojë që disa dokumente ekzistojnë dhe të njëjtat t’i verifikoj, nëse ato ekzistojnë në organet publike.

Kushtet dhe kriteret specifike për dhënien e licencave. Në rastin e ARKEP, dokumentet e nevojshme për një licencë, janë mjaft specifike sepse ndërlidhen edhe me: mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë publike; Sigurinë dhe mbi të gjitha kushtëzohen me rregullat ndërkombëtare të aviacionit civil. Duke marrë parasysh specifikat e licencave të ARKEP, atëherë në disa raste edhe dokumentacioni është specifik. Andaj, në bazë të analizës, reduktimi i dokumentacionit është kërkuar rast pas rasti, bazuar në dy alternativa: 1. Verifikimi i disa fakteve përmes deklaratës nën betim dhe 2. Identifikimi nga pala e disa dokumenteve si dhe veprimi i ARKEP, sipas parimit të ndihmës administrative dhe zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare.

Dorëzimi i dokumentacionit në origjinal. Në kuadër të lejimeve që miraton ARKEP, ka një fenomen bazuar në Regjistrin Qendror të Lejeve dhe Licencave (RQLL) dhe ky fenomen ka të bëjë me dorëzimin e disa dokumenteve në origjinal, përfshirë edhe ato dokumente që përbejnë fakte notore dhe madje të pakontestueshme, siç është certifikata e regjistrimit të biznesit ose dëshmitë tjera për themelimin e shoqatës ose konzercionit (varësisht nga lloji i lejit) ose statuti i saj, etj. Andaj, ngritja e këtij parimi është bërë me qëllim që një gjë e tillë të konkretizohet tek rekomandimet e veçanta, të përcaktuara në shtojcën e kësaj analize.

3. Analiza ligjore përkitazi me harmonizimin e lejeve dhe licencave me kriteret e LSL

Përkitazi me këtë raport, harmonizimi nënkupton një proces të përshtatshmërisë së LSL në rastin konkret dhe LKE dhe LSHP, me qëllim të përcaktimit të lejeve dhe licencave që lëshon ARKEP, bazuar në LSL. Lidhur me aspektin e harmonizimit janë me rëndësi të evidentojmë çështjet si në vijim:

Përcaktimi i lejeve dhe licencave me ligj. Ky parim përcaktohet në nenin 17.1 të LSL dhe si i tillë nënkupton që leja dhe licenca, qoftë edhe në kuptimin e emërimit të përcaktohet me ligj. Në rastin e ARKEP vetëm disa leje dhe licenca përcaktohen me ligj. Një karakteristikë e lejeve dhe licencave në ARKEP është, që një pjesë e madhe e tyre përcaktohen vetëm me akte nënligjore (rregullore) të ARKEP, në kundërshtim me nenin 17.1 të LSL. Megjithatë aktet nënligjore dhe përcaktimi i licencave me këto akte, janë analizuar në shtojcën e këtij raporti.

Emërtimet e lejeve dhe licencave të përcaktohen me ligj: Kjo kërkon që të gjitha lejet dhe licencat që lëshon ARKEP, si: Autorizimet; Lejet dhe Licencat; të përcaktohen me ligj në mënyrë specifike. Një numër i caktuar i kategorive të lejeve dhe licencave që lëshohen nga ARKEP, siç janë autorizimet, të cilat nuk kanë bazë ligjore konkrete. Po ashtu, në kuadër të rekomandimeve të veçanta, për secilën autorizim dhe

licencë janë dhënë rekomandime të veçanta, në kuptimin nëse lloji i lejes dhe licencës është i përcaktuar me ligj.

Përshtatshmëria e lejeve dhe licencave sipas nenit 5 të LSSL: Neni 5 i LSSL përcakton llojet e lejimeve të cilat janë: njoftim, regjistrim, leje dhe licenca profesionale. Në këtë rast edhe emërtimet e lejimeve që i bën ARKEP duhet ti përshtaten këtij.

Kategorizimi i lejeve dhe licencave sipas rrezikut: ARKEP duhet të përcaktojë një sistem të kategorizimit të lejeve dhe licencave, sipas rrezikut, sikurse e përcakton edhe neni 19 i LSSL. Për këtë duhet të plotësohet ose duhet të krijohet një nen i ri në LKE.

4. Të gjeturat

1. Të krijohet bazë e qartë ligjore për licencat ekzistuese
2. Të gjitha licencat e ARKEP janë me afat të caktuar sipas kategorive, ndërsa LSSL, nuk rregullon çështjen e ri licencimit ose vazhdimit të licencës.
3. Nuk zbatohet parimi i ndihmës administrative për të lehtësuar procedurën e verifikimit të dokumenteve të nevojshme që dorëzohen për licencë.
4. Nuk zbatohet parimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, për verifikimin e dokumenteve të identifikuar nga palët, që i posedojnë institucionet publike.
5. Disa dokumente që janë notore dhe mund të vërtetohen lehtësisht, me rastin e aplikimit për licencë kërkohen të dorëzohen në origjinal.
6. Një numër i dokumenteve që kërkohen tek kategoria e kërkesave të përgjithshme, duken që shtojnë barrën administrative për mënyrën se si kërkohen.
7. Në ARKEP lëshon autorizime që nuk përcaktohen shprehimisht me ligj, sipas emërimit të tyre aktual.

5. Rekomandimet kryesore

1. Të krijohet bazë e qartë ligjore për licencat ekzistuese të ARKEP;
2. Të zgjatet afati i dhënies së licencës nga ARKEP, respektivisht të përcaktohet një afat minimal për kategoritë e licencave;
3. Të bëhet harmonizimi i ligjit për LKE, respektivisht plotësimi i Ligjit, në kuptimin e emërimit të licencave nga ARKEP, për veprimtaritë që nuk kërkojnë licencë, bazuar në nenin 5 të LSSL.
4. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
5. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
6. Të verifikohen disa dokumente të nevojshme sipas deklaratës nën betim;
7. Pagesa e taksave fillestare të shqyrtimit të bëhet pas aprovimit të kërkesës dhe të rishikohet taksa e rishikimit të licencës me kërkesë të ARKEP;
8. Të bëhet lirimi nga taksa, në rast të modifikimit të licencës me iniciativë të ARKEP;
9. Ti mundësohet palës që të ofrojë dëshmi e prova shtesë, përgjatë shqyrtimit të procedurës, deri në afatin e fundit të vendosjes;
10. Të nxjerrët një rregullore përkatëse që rregullon procedurat e aplikimit dhe shqyrtimit të lejeve dhe licencave, sipas parimeve të LPPA dhe LSSL.
11. Lartësia e tarifave të jetë proporcionale me shpenzimet e nevojshme administrative gjatë procedurës së dhënies së licencës.
12. Të aplikohet afati 45 ditor i vendosjes për kërkesat për leje dhe licenca, sipas LPPA.

6. Arsyetimi i rekomandimeve kryesore

1. Të krijohet bazë e qartë ligjore për licencat ekzistuese të ARKEP. Bazuar në nenin 17.2 të LSSL lejet dhe licencat përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret të ARKEP janë të përcaktuara veprimtaritë që duhet të kenë licencë. Në anën tjetër, sa i përket autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja, si lejime, nuk përcaktohet një bazë konkrete ligjore e lejes ose licencës, sipas emërimit. Rekomandimet e veçanta për këtë çështje janë dhënë në kuadër të shtojcës.

2. Të zgjatet afati i dhënies së licencës nga ARKEP, respektivisht të përcaktohet një afat minimal për kategoritë e licencave. Duke pasur parasysh parimin e efikasitetit, për aq sa është e mundur duhet që të zgjatet afati i lejeve dhe licencave që jepen për afat të shkurtër. Kjo duhet të bëhet duke pasur parasysh sigurinë, mbrojtjen e shëndetit publik dhe kriteret e tjera që i përcakton ARKEP.

3. Të bëhet harmonizimi LKE dhe LSSL, sipas parimeve të përcaktuara. Me qëllim të harmonizimit të lejeve dhe licencave, në bazë të të gjeturave dhe rekomandimeve sa i përket harmonizimit, duhet që LKE të harmonizohet me LSSL, duke ndryshuar dhe plotësuar, sipas nevojës nenet e caktuara të LKE, pavarësisht që me këtë ligj janë parapare llojet e lejeve dhe licencave apo te autorizimeve.

4. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike. ARKEP duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Përmes aplikimit të këtij parimi, ARKEP do të verifikojmë një numër të dëshmimeve, të cilat nevojiten që të dorëzohen nga pala me parashtrimin e kërkesës. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, ARKEP do të shmang dorëzimin e disa dokumenteve, me rastin e aplikimit të palëve për leje dhe licenca.

5. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio. Me rastin e ripërtërirës së licencës, sidomos kur këtë e kërkon ARKEP, procedura e verifikimit të fillohet dhe të përfundohet duke respektuar veprimin e ndërmarrjes së procedurave sipas detyrës zyrtare. Ky parim do të vinte në shprehje edhe me rastin e ripërtërirës së licencës si dhe modifikimit të saj.

6. Të verifikohen disa dokumente të nevojshme sipas deklaratës nën betim. Disa dokumente të nevojshme me rastin e aplikimit për licenca dhe lejime në ARKEP rekomandohet të reduktohen, për të lehtësuar barrën administrative. Reduktimi i këtyre dokumenteve mund të bëhet në atë mënyrë që disa çështje që duhet të jenë pjesë e aplikacionit, të vërtetohen përmes deklaratës nën betim, duke pasur parasysh faktin që sipas ligjit për ARKEP licenca mund të tërhiqet në rast se aplikuesi ofron të dhëna të pa vërteta.

7. Pagesa e taksave fillestare të shqyrtimit të bëhet pas aprovimit të kërkesës. Duke pasur parasysh pagesën e taksave dhe faktin që këto taksave janë të llogaritura në bazë të parimit e llogaritjes në pajtim me shpenzimet specifike administrative të arsyeshme të shkaktuara në trajtimin e akteve të cilat u referohen taksat e tilla. Për të lehtësuar barrën administrative, taksa fillestare duhet të paguhet në mënyrë elektronike si dhe pasi që të miratohet kërkesa e aplikuesit.

8. Të bëhet lirimi nga taksa, në rast të modifikimit të licencës me iniciativë të ARKEP. Në rast të modifikimit të licencës, me kërkesë të ARKEP, është barrë administrative që pala të paguaj taksë në rastin e modifikimit. Andaj, duhet të vendoset që të ndryshohet rregullorja dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, pala nuk duhet të ngarkohet me pagesat e taksës, në rast të modifikimit me iniciativë të ARKEP.

9. T'i mundësohet palës që të ofrojë dëshmi e prova shtesë, përgjatë shqyrtimit të procedurës, deri në afatin e fundit të vendosjes. Në bazë të parimit të dëgjimit të palës, për të lehtësuar qasjen e aplikuesve, ARKEP duhet të lejojë plotësimin e dokumentacionit për aplikuesin, deri në përfundimin e afatit të

shqyrtimit të licencës. Kjo do t'i ndihmojë palës që të ketë qasje më të lehtë në aplikimin dhe shqyrtimin e licencës ose lejimit që lëshon ARKEP.

10. Të nxjerrët një rregullore përkatëse që rregullon procedurat e aplikimit dhe shqyrtimit të lejeve dhe licencave, sipas parimeve të LPPA dhe LSSL. Me qëllim të rregullimit të procedurës së unifikuar që garanton zbatimin e parimeve të LPPA dhe LSSL, duhet të nxjerrët një rregullore që ka për objekt trajtimin e procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit e të gjitha lejeve dhe licencave në kuadër të ARKEP, bazuar në parimet e LPPA dhe dispozitat e LSSL.

11. Lartësia e tarifave të jetë proporcionale me shpenzimet e nevojshme administrative gjatë procedurës së dhënies së licencës. LSSL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për aq sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në përputhje me këtë parim duhet të jetë edhe niveli i taksës. Për më tepër, është e nevojshme që tarifa të jetë fikse dhe mos të përcaktohet përmes elementeve dytësore që mundësojnë caktimin e tarifës. Një qasje e tillë ka potencial të paraqesë diskriminim apo pasiguri juridike. Për këtë arsye, ARKEP duhet të përcaktojë tarifa fikse.

12. Të aplikohet afati 45 ditor i vendosjes për kërkesat për leje dhe licenca, sipas LPPA - Me qëllim të lehtësimit të procedurës dhe barrës administrative, ARKEP duhet të aplikojë afatin e vendosjes për kërkesën për leje dhe licencë, prej 45 ditësh, në pajtim me kërkesat e LPPA. Aplikimi i afatit 45 ditor do të zvogëlonte kohëzgjatjen e vendosjes dhe do të rriste efikasitetin si dhe lehtësonte barrën administrative të palës.

7. Zbatimi i rekomandimeve të përgjithshme dhe të veçanta

Në kuadër të raportit, janë dhënë rekomandimet e përgjithshme dhe ato të veçanta, të paraqitura në shtojcë për secilën autorizim dhe licencë. Duhet konstatuar, se për shkak të faktit se LKE njeh lejimet, respektivisht licencë dhe autorizim, rekomandimet e veçanta në shtojcë, për licenca dhe autorizim kanë rezultuar të jenë të ngjashme.

Zbatimi i rekomandimeve të përgjithshme dhe të veçanta, sipas shtojcës mund të bëhet në dy mënyrë dhe atë: 1. Përmes të plotësimeve dhe ndryshimeve të LKE dhe 2. Përmes plotësimeve dhe ndryshimeve të rregulloreve të brendshme të ARKEP, për rregullimin e procedurave për lëshimin e licencave dhe autorizimeve të ARKEP.

SHTOJCA

Në shtojcë janë përfshirë lejet dhe licencat e lëshuara nga ARKEP, sipas renditjes në RQLL

1. KONFIRMIM I NJOFTIMIT PER FILLIMIN E AKTIVITETEVE TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

1. Të gjeturat kryesore

1.1 Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Kjo licence është bazuar në Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike tek neni 4 (1.2): “**Autorizim i përgjithshëm** – akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga korniza ligjore, e përcaktuar nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga Autoriteti, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve specifike të komunikimeve elektronike”; si dhe tek neni 16 (1). Autoriteti miraton listën e llojeve të aktiviteteve të komunikimeve elektronike për të cilat një ndërmarrës duhet të njoftojë Autoritetin, nëse ai kërkon të përfshihet në ndonjërin prej atyre aktiviteteve. Ndërmarrësi ka të drejtë për t’u përfshirë në aktivitetin përkatës, pas njoftimit të Autoritetit, në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti si dhe nenin 20: “Ndërmarrësit, që ndërtojnë dhe/ose përdorin rrjete publike të komunikimeve elektronike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut janë të detyruar të zbatojnë kushtet e këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe rregulloret e nxjerra në zbatim të këtij ligji, që të mos rrezikojnë rendin publik, jetën dhe shëndetin e qytetarëve, sigurinë publike dhe mbrojtjen e vendi”. Si dhe nenin 4 të Rregullores për Autorizimet e Përgjithshme Nr. 37 Prot.ARKEP 019/B/19.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Njoftimi për ofrimin e shërbimeve dhe/ose rrjeteve të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës për lejin e ushtrimit të këtij aktiviteti.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Konfirmimi/autorizimi lëshohet për afat të pacaktuar.

1.4 Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

Procedura e aplikimit është pa pagesë

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Formulari i njoftimit për hyrje në aktivitetin e komunikimeve elektronike [Origjinal]
2. Çertifikata e regjistrimit të biznesit dhe informatë mbi biznesin [Kopje]
3. Çertifikata e numrit fiskal [Kopje]

2.Rekomandimet

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj;
2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
3. Disa dokumente të nevojshme për aplikim për këtë autorizim të vërtetohen sipas parimit të ndihmës së organeve administrative dhe veprimit ex officio ose përmes deklaratës nën betim, e dorëzuar nga pala.

3.Arsyetimi i rekomandimeve

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj. LSSL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LKE dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSSL. Po ashtu, neni 17.1 i LSSL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj.
2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio. Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimit ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e ARKEP. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSSL.
3. Lidhur me dokumentet respektive që pala duhet të dorëzojë, me rastin e aplikimit, disa prej tyre mund të verifikohen sipas parimit të ndihmës juridike në mes të organeve si dhe parimit të zhvillimit ex officio të procedurës apo përmes deklaratës nën betim. Dokumentet e tjera mbetën të dorëzohen sipas kërkesës së ARKEP, pasi që përbëjnë dokumente specifike, përsa i përket nevojës së identifikimit të aspekteve specifike, përsa i takon kësaj licence.

4. AUTORIZIM INDIVIDUAL PER RADIOFREKUENCA

1.Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Kjo licence ka bazën në Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, pra, nenin 47 (4): *“Personi mund të fillojë të shfrytëzojë resurset e komunikimeve elektronike nga data e lëshimit të autorizimit përkatës nga Autoriteti, përveç në rastet kur është specifikuar ndryshe në autorizim. Autorizimi për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike duhet t’iu jepet atyre personave të cilëve iu është dhënë resursi i komunikimeve elektronike në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti. (5) Numri i autorizimeve për shfrytëzim të resurseve të komunikimeve elektronike duhet të jetë i palimituar, përveç në rastet kur kufizimet janë të domosdoshme për të siguruar shfrytëzim efektiv të radio-frekuencave (kanaleve), në rastet kur resurset e caktuara të komunikimeve elektronike kanë vlerë ekonomike të posaçme dhe/ose në rastet kur kufizimi i resurseve të komunikimeve elektronike është i pashmangshëm dhe arsyetohet duke u bazuar në principin e proporcionalitetit”*

Si dhe rregulloren Nr.Prot.054/B/13: Rregullore për dhënien dhe Shfrytëzimin e Radio Frekuencave, ku në nenin dy referohet Autorizim (Autorizimi individual); nënkupton dokumentin e shkruar, të lëshuar nga Autoriteti dhe/apo i regjistruar në bazën e të dhënave elektronike në dispozicion për publikun, i administruar nga Autoriteti, duke i dhënë të drejtën për të shfrytëzuar radio frekuencën/kanalin e specifikuar në pajtim me kushtet e specifikuara në/autorizim dhe të bazuar nga aktet e aplikueshme ligjore; Gjithashtu, me këtë rregullore të Neni 3, rregullohet “Procedura e Përgjithshme për dhënien (përcaktimin) dhe shfrytëzimin e radio frekuenca”

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Dhënia e autorizimeve shfrytëzuesve për të ngritur dhe operuar sisteme radiokomunikimi

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Konfirmimi lëshohet minimum për 6 muaj dhe më shumë.

1.4.Taksa e nevojshme për pagesë

Pagesë për shfrytëzimin e radiofrekuencave - varësisht nga parametrat e rrjetës, përcaktuar me rregullore, minimumi 75 euro

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Kërkesë për Aplikim [Origjinal]
2. Formulari i aplikimit [Origjinal]
3. Çertifikata e regjistrimit të biznesit dhe informatë mbi biznesin [Kopje]
4. Kopja e Licencës nga KPM (për shërbimet Radio dhe TV) [Kopje]
5. Licenca për operim e lëshuar nga MPB, për ofrues të shërbimeve të sigurimit privat [Kopje e verifikuar]

2.Rekomandimet

1. Të zgjatet afati i dhënies së licencës;
2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
3. Disa dokumente të nevojshme për aplikim për këtë autorizim të vërtetohen sipas parimit të ndihmës së organeve administrative dhe veprimit ex officio ose përmes deklaratës nën betim, e dorëzuar nga pala.
4. Taksa për autorizimin të paguhet në rast të miratimit të kërkesës dhe nxjerrjes së vendimit për miratim.
5. Të rishikohet tarifa për aplikim;

3.Arsyetimi i rekomandimeve

1. Të zgjatet afati i dhënies së licencës. Zgjatja e afatit për këtë licencë është me rëndësi për shkak të parimit të sigurisë juridike për aplikuesin, në kuptimin e qëndrueshmërisë dhe kohëzgjatjes. Andaj duhet të caktohen kritere objektive dhe të matshme në rregullore për sa i takon kohëzgjatjes së licencës. Duke parë që kohëzgjatja e këtyre llojeve të autorizimeve ka një rëndësi për palën, duhet të shikohet mundësia që kohëzgjatja e këtyre autorizimeve. Një gjë e tillë mund të përcaktohet me rregull të nxjerrë nga ARKEP ose ndryshimin e rregullores, për të përcaktuar një afat më të gjatë të vlefshmërisë së autorizimeve, me qëllim që ndaj palëve të ketë një qasje më fleksibile dhe lehtësuese lidhur me këtë lloji të lejimit.
2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio. Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimit ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e ARKEP. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSSL.
3. Lidhur me dokumentet respektive që pala duhet të dorëzojë, me rastin e aplikimit, disa prej tyre mund të verifikohen sipas parimit të ndihmës juridike në mes të organeve si dhe parimit të zhvillimit ex

oficio të procedurës apo përmes deklaratës nën betim. Dokumentet e tjera mbetën të dorëzohen sipas kërkesës së ARKEP, pasi që përbëjnë dokumente specifike, përsa i përket nevojës së identifikimit të aspekteve specifike, përsa i takon kësaj licence.

4. Përsa i përket taksës, ARKEP duhet të bëjë përpjekje që taksën fillestare, palëve të ja mundësoj që ta paguajnë, pasi që të përfundojë procedura dhe pasi të njëjtëve ti miratohet kërkesa. Kjo do të lehtësonte barrën administrative të palëve dhe do të zbatonte parimin e njohur nga LPPA, për zhvillimin e një procedure pa ngarkesa financiare për palën.
5. Të rishikohet tarifa për aplikim. LSSL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për atë sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSSL. Po ashtu, duhet të përcaktohet që e gjithë pagesa e taksës të bëhet vetëm pasi të lëshohet licenca dhe jo në momentin e aplikimit.

1. AUTORIZIMET INDIVIDUALE PËR RESURSE NUMERIKE

1.1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Ky autorizim e ka bazën në Rregulloret Nr. 50 (Nr.Prot.011/B/21) Rregullores me nr. 50 për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës (Ref. Nr. Prot. 011/B/21; dt.10/03/2021), të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren me nr. 62 (Ref. Nr.Prot.014/B/14),) dhe Rregulloren me nr. 65 (Ref. Nr.Prot. 051/B/24).

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet autorizimi:

Jepet e drejta e përdorimit të resurseve numerike për kodet e shkurta 1x, për shërbimet e numrave premium 9x, për numrat special 8x (pa pagesë), për kodet e shkurtëra për pranimin dhe dërgimin e SMS-ve me vlerë të shtuar 5x, për përdorimin e numrave të telefonisë fikse 2x dhe 3x dhe për telefoninë mobile 4x.

1.3 Vlefshmëria kohore e autorizimit:

Për shfrytëzuesit, të cilët nuk janë ofrues të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, periudha kohore e caktimit në shfrytëzim të numrave do të jetë e pa kufizuar për serinë 1x dhe një (1) deri pesë (5) vite për seritë 5x, 8x dhe 9x.”.

Periudha kohore e caktimit në shfrytëzim të resurseve numerike për ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike është e pa-kufizuar, përveç nëse nuk është e specifikuar ndryshe me vendim të Autoritetit.

1.4. Pagesa e taksës

Pagesë për përdorimin e numrave premium 9x - 60 Euro/1 vit;

Pagesë për përdorimin e numrave special 8x - 15 Euro/vit;

Pagesë për përdorimin e numrave të shkurtër 5x-15 Euro/vit;

Pagesë për përdorimin e numrave gjeografik 2x dhe 3x -0.025 cent/ euro;

Pagesë për përdorimin e numrave jo gjeografik mobil 4x -0.04 cent/ euro

Pagesë për përdorimin e kodeve të shkurta 1x – pa pagesë;

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Formulari i aplikimit [Original]
2. Kërkesa
3. Varësisht prej kërkesës mund të kërkojnë dokumente shtesë

2.Rekomandimet

1. Ky autorizim të përcaktohet me ligj;
2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio;
3. Disa dokumente të nevojshme për aplikim për këtë autorizim të vërtetohen sipas parimit të ndihmës së organeve administrative dhe veprimit ex officio ose përmes deklaratës nën betim, e dorëzuar nga pala.
4. Të rishikohet tarifa për aplikim;

3.Arsyetimi i rekomandimeve

1. Kjo licencë të përcaktohet me ligj. LSSL është ligj horizontal, në përputhje me të cilin Ligj duhet të jenë edhe ligjet e tjera. Në LKE dhe aktet përkatëse nënligjore duhet të adresohet kjo çështje dhe emërtimi të jetë në përputhje me LSSL. Po ashtu, neni 17.1 i LSSL përcakton që licencat duhet të përcaktohen vetëm me ligj.
2. Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio. Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtërija e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimit ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e ARKEP. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSSL.
3. Lidhur me dokumentet respektive që pala duhet të dorëzojë, me rastin e aplikimit, disa prej tyre mund të verifikohen sipas parimit të ndihmës juridike në mes të organeve si dhe parimit të zhvillimit ex officio të procedurës apo përmes deklaratës nën betim. Dokumentet e tjera mbetën të dorëzohen sipas kërkesës së ARKEP, pasi që përbëjnë dokumente specifike, përsa i përket nevojës së identifikimit të aspekteve specifike, përsa i takon kësaj licence.
4. Të rishikohet tarifa për aplikim. LSSL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për atë sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSSL. Po ashtu, duhet të përcaktohet që e gjithë pagesa e taksës të bëhet vetëm pasi të lëshohet licenca dhe jo në momentin e aplikimit.

5. CERTIFIKATE E KONFIRMIMIT TE NJOFTIMIT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE

1.Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Kjo licence ka bazën në Ligji Nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare, pra, në nenin 7 paragrafi 2 (2.2): “Për përmbushjen e detyrave në fushën e shërbimeve postare, Autoriteti ka kompetencat dhe përgjegjësitë në vijim: ...; 2.2. lëshon dhe tërheq autorizimet, të dhëna në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore”. Si dhe nenin 16, paragrafi 2: “Ofrimi i shërbimeve postare në Republikën e Kosovës bëhet sipas autorizimit të lëshuar nga Autoriteti. Po ashtu në nenin 20 Çdo person fizik ose juridik, i cili, për qëllime fitimi, shpreh interes të ofrojë shërbime postare, duhet të njoftojë Autoritetin, përpara fillimit të ofrimit të shërbimit postar. Si e tillë baza ligjore për licencim të këtij aktiviteti në ligjin për LSHP. Si dhe Nenin 8 të Rregullores Nr. 41, Për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Shërbime postare mund të ofrojnë personat fizik ose juridik të cilët janë pajisur me licencë nga ARKEP për ofrimin e shërbimeve postare. Një procedurë e tillë ndikon në rregullimin e tregut, mos diskriminim, krijim të kushteve për konkurrencë fer, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve postare, etj

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Certifikata për Konfirmim të Njoftimit për Ofrim të Shërbimeve Postare është pa afat

1.4. Pagesa e taksës

- 50 Euro- për aplikim;
- Shërbime Vendore (V) = 1000 Euro;
- Shërbime Vendore + ndërkombëtare (V/N) = 1500 Euro

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Formulari i njoftimit për ofrimin e shërbimeve postare
2. Certifikata e regjistrimit të biznesit dhe informate mbi biznesin [Kopje]
3. Kopje të letërnjoftimit, ID personit/va fizik bartës të biznesit
4. Kopje e dokumentit informativ mbi biznesin (Plan i Biznesit)
5. Përshkrimi i shkurtër i rrjetit dhe/ose shërbimit/eve postare që kërkon të ofrojë dhe Tarifatat e parashikuara për ofrimin e shërbimeve postare

2.Rekomandimet

1. Të bëhet ripërtëritja e licencave sipas parimit ex officio;
2. Disa dokumente të nevojshme për aplikim për këtë autorizim të vërtetohen sipas parimit të ndihmës së organeve administrative dhe veprimit ex officio ose përmes deklaratës nën betim, e dorëzuar nga pala.
3. Taksa për autorizimin të paguhet në rast të miratimit të kërkesës dhe nxjerrjes së vendimit për miratim.
4. Të rishikohet tarifa për aplikim;

3.Arsyetimi i rekomandimeve

1. Të bëhet ripërtëritja e licencave sipas parimit ex officio. Në rastet kur nuk është e mundur që kjo licencë të ipet pa afat të caktuar, ripërtëritja e kësaj licence duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare, përmes ndonjë procedurë të verifikimit ex-officio të fakteve dhe jo përmes një procedure të re administrative për aplikim. Kjo mund të përcaktohet me akt nënligjor nga ana e ARKEP. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSSL.
2. Lidhur me dokumentet respektive që pala duhet të dorëzojë, me rastin e aplikimit, disa prej tyre mund të verifikohen sipas parimit të ndihmës juridike në mes të organeve si dhe parimit të zhvillimit ex officio të procedurës apo përmes deklaratës nën betim. Dokumentet e tjera mbetën të dorëzohen sipas kërkesës së ARKEP, pasi që përbëjnë dokumente specifike, përsa i përket nevojës së identifikimit të aspekteve specifike, përsa i takon kësaj licence.
3. Përsa i përket taksës, ARKEP duhet të bëjë përpjekje që taksën fillestare, palëve të ja mundësojë që ta paguajnë, pasi që përfundojë procedura dhe pasi të njëjtëve ti miratohet kërkesa. Kjo do të

lehtësonte barrën administrative të palëve dhe do të zbatonte parimin e njohur nga LPPA, për zhvillimin e një procedure pa ngarkesa financiare për palën.

4. Të rishikohet tarifa për aplikim. LSLL në nenin 18 përcakton një taksë proporcionale, për atë sa ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Një gjë e tillë mund të bëhet përmes akteve nënligjore, siç e përcakton neni 17.2 i LSLL. Po ashtu, duhet të përcaktohet që e gjithë pagesa e taksës të bëhet vetëm pasi të lëshohet licenca dhe jo në momentin e aplikimit.